



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Karburanti për ngrohjen e sallave të leksioneve për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

09134000-7 - Naftë, 44115220-7 - Materiale ngrohje

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,039,740 (katër milion e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë) lekë pa tvsh nga të cilat:

Fakulteti i Mjekësisë 3,192,657 (tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike 847,083 (tetëqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

*c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1/1.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë::**

**2.1.1** Subjekti duhet të paraqesë licencë për tregtimin me shumicë (VIII.1.A për kategorinë III/Ç (Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial) ose tregëtimin me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë, për lëndën djegëse sipas objektit të prokurimit, të lëshuar nga organet kompetente.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021,2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021,2022) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për

plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë / raport analizë për produktin e ofruar sipas kërkesave të DST, lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, sipas standarteve të përcaktuara dhe në pajtueshmëri me specifikimet teknike në fuqi të lëshuar jo më parë se tre muaj nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma ”c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 429, datë 26.06.2019 “Për cilësinë e lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim teknik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave

objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e karbuarantit për ngrohje në objektet arsimore dhe administrative, karburanti duhet të jetë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe operatorët ekonomikë ofertues duhet të dëshmojnë që ofrojnë produkte minimalisht me karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit nga natyra e përdorimit është shumë e rëndësishme përmbushja e specifikimeve teknike pasi do të përdoren në impiante ngrohës ku zhvillohet aktiviteti.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a- Lejen e mjedisit sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin, lëshuar nga QKL;
- b- Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI / nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- c- Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri/Akt teknik lëshuar nga MZSH;
- d- Policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë,

(të gjitha dokumentat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Në lidhje me kriterin e lejes mjedisore kjo kërkesë është referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 152 date 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve në mjedis të instalimeve ndotëse, duke respektuar standartet kombëtare. Akti teknik lëshuar nga PMNZH është i rëndësishëm, pasi tregon që operatori ekonomik ofertues ka marrë masa dhe vepron në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në pronësi të vet ose me qira të paktën 2 (dy) automjete transporti autobot karburanti me kapacitet 1,000-5,000 litra, e vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale ose akt pronësie ose të jene të pasqyruara në ekstraktin e QKR, etj). Për këtë duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikatën për transportin e lëndëve të rrezikshme dhe pashaportën e mjetit për kapacitetin mbajtës në litra.

*Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë*

*autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e mallrave objekt prokurimi në objekte të shpërndara në disa godina te ndryshme, automjetet e mësipërme konsiderohen të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë në bazë të së cilës merr përsipër furnizimin me karburante me botet e tij dhe shpenzimet e tij deri në vendin ku ndodhen depozitat e autoriteteve kontraktore përfituese.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me bot me shërbim 24 orë, sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore.

**Argumentimi:** Deklaratat i japin garanci Autoritetit Kontraktor për përmbushjen me sukses të objektit të prokurimit.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit me nr. 2515/7, datë 09.10.2023 në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar bazuar në kërkesat e njëjsteve shpenzuese, procedurave të mëparshme dhe referuar Standartit Shqiptar SSH UNI 6579:2011, mbi klasifikimin dhe karakteristikat e lëndëve djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial.

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë*

*cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT:**